



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:165422

Datë: 09.12.2023

Numri i dokumentit: 05040091

**P.nr. 843/20**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**, sipas gjyqtarit të vetëm gjykues Veton Ademaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kaltrina Rexhepi – Imami, në çështjen penale kundër të pandehurit Sh. Sh. nga P., rr. ” ” nr..., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1, lidhur me nenin 77 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.2057/20, të dt.24.11.2020, jashtë seancës, me datë 09.12.2023, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**I.APROVOHET** marrëveshja për ndërmjetësim me numër reference Nd.nr.2380/23 e datës 05.12.2023, e lidhur në mes të pandehurit SH .Sh. nga P., rr. ” ” nr... dhe të dëmtuarit KEDS-me seli në Prishtinë.

**II.HEDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2057/20, e datës 24.11.2020.

**III.PUSHOHET** procedura penale kundër të pandehurit Sh. Sh. nga P., rr. ” ” nr..., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

**IV.** Shpenzimet e procedurës bien në barrë të buxhetit të kësaj gjykate.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.2057/20, të dt.24.11.2020, kundër të pandehurit Sh. Sh. nga P., rr. ” ” nr., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Gjykata, me datë 05.12.2023 ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën kanë prezantuar prokurori i shtetit L. H, i pandehuri Sh .Sh, së bashku me avokatin mbrojtës V. B, caktuar sipas detyrës zyrtare.

Para leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i pandehuri konform nenit 241 të KPPRK-së është njoftuar konform nenit 241 të KPPRK-së për të drejtat e tij, dhe pas deklarimit të të pandehurit që i ka kuptuar të drejtat e tij, mbrojtësit i të pandehurit av. V. B. propozojë që lënda të dërgohet në procedurë të ndërmjetësimit pasi që plotësohen kushtet sipas KPRK-së.

Pas marrjes së miratimit nga ana e prokurorit të shtetit dhe të pandehurit lënda është dërguar në Qendrën e Ndërmjetësimit në Pejë.

Qendra e Ndërmjetësimit në Pejë me datë 05.12.2023 e ka njoftuar gjykatën se i pandehuri dhe i dëmtuari janë pajtuar dhe kanë arritur marrëveshje të ndërmjetësimit me numër reference Nd.nr.2380/23 me datë 05.12.2023.

Gjykata pas vlerësimit të marrëveshjes për ndërmjetësim, gjeti se palët kanë lidhur marrëveshjen e ndërmjetësimit me vullnet të lirë dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-009 Për Ndërmjetësim, përkatësisht nenet 12 dhe 15 paragrafi 1, andaj të njëjtën e aprovoi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata vendosi si në pikën II dhe III të dispozitivit, përkatësisht hodhi aktakuzën dhe pushoi procedurën penale ndaj të pandehurit, duke u bazuar në nenin 229 paragrafi 5 dhe nenin 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPPRK-së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Nga të lartë cekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**P.nr. 843/20 me datë 09.12.2023**

**Gjyqtari**  
Veton Ademaj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi.